



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUÇITRN

Nr. / Br. 8658/26

Nr. i fq. / Br. sh. - 2 -

Data: / Datum: 27.02.2026

VUSHTPISI - VUÇITRN



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
**Komuna e Vushtrrisë**  
Opština Vuçitrn – Municipality of Vushtrri

### **Kuvendi i Komunës**

#### **01 Nr. PB 35/26 27/02/2026**

Në bazë të nenit 12.2 “d” të Ligjit nr. 03/L-40/2008 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 4, 5, 6, dhe 21 pika 1.1 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, nenit 25 të Rregullores (QRK) për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Planin Zhvillimor Komunal të Komunës të Vushtrrisë dhe nenit 19 paragrafi 2 pika 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **26 shkurt 2026** merr këtë:

### **V E N D I M**

#### **PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS NR.01.189/23 DATË 28.07.2023**

**1.** Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet pika 1 e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit **Nr.01.189/23 i datës 28.07.2023 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës**, Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, që lidhet me financimin e projektit për ndërtimin e parkingut nëntokësor dhe zgjerimi i hapësirave të shërbimit të emergjencës për nevoja të spitalit të Vushtrrisë në Komunën e Vushtrrisë, ndërsa ndryshimet bëhen si në vijim:

**1.1.** Dhënia e pronës komunale parcela kadastrale P-70202016-02358-7 me sipërfaqe prej 7380 m<sup>2</sup> ZK – Vushtrri pronë e Komunës së Vushtrrisë e evidentuar në emër PSH. Shtëpi e Shëndetit jepet në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës në afat prej 40 viteve, me mundësi vazhdimi me qëllim të realizimit të projektit ndërtimi dhe zgjerimi i hapësirave të reja spitalore për nevoja e Spitalit “Sheikh Zayed” në Vushtrri.

**1.2.** Prona e cekur si në pikën 1.1 të këtij vendimi do të shfrytëzohet vetëm për nevojat e Spitalit “Sheikh Zayed” në Vushtrri, nuk lejohet shfrytëzimi për qëllime tjera.

- 1.3. Në kuadër të pikës 1 të vendimit bazë bëhet ristrukturimi i projekti, ku nuk parashihet ndërtimi i parkingut nëntokësor, por vetëm bëhet zgjerimi i hapësirave të reja spitalore për nevoja të Spitalit “Sheikh Zayed” në Vushtri.
2. Pikat të tjera të vendimit bazë Nr.01.189/23 i datës 28.07.2023 mbeten të pandryshuara.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.
4. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**  
  
\_\_\_\_\_  
**Kryesuese e Kuvendit**





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN	
Nr. / Br.	8660126
Nr. i fq. / Br. st.	-1-
Data: / Datum:	27.02.2026
VUSHTRRI - VUÇITRN	



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
**Komuna e Vushtrrisë**  
Opština Vuçitrn – Municipality of Vushtrri

### Kuvendi i Komunës

**01 Nr. PB 36/26 27/02/2026**

Në bazë të nenit 12.2 “d” të Ligjit nr. 03/L-40/2008 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 19 paragrafi 2 pika 1.4 të Statutit të Komunës, si dhe duke u bazuar në kërkesën e Asociacionit të Komunave të Kosovës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **26 shkurt 2026**, merr këtë:

## V E N D I M

### PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË NË KUVENDIN E PËRGJITHSHËM TË ASOCIACIONIN E KOMUNAVE TË KOSOVËS

1. Me këtë vendim emërtohen anëtarët e kuvendit të Komunës së Vushtrrisë të cilët do ta përfaqësojnë Kuvendin Komunal të Vushtrrisë në Kuvendin e përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Kosovës në përbërjen si në vijim:

- 1.1. **Vlerë Tahiri anëtare e Kuvendit (PDK);**
- 1.2. **Refik Maloku, anëtar i Kuvendit (LVV);**
- 1.3. **Ramadan Parduzi, anëtar i Kuvendit (LDK).**

2. Kryetari i Komunës përfaqëson Komunën e Vushtrrisë sipas detyrës zyrtare me përfaqësim direkt, ndërsa partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë propozojnë nga një përfaqësues.

3. Anëtarët e emëruar në pikën 1 të këtij vendimi, emërohen me mandat të njëjtë si të anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: kryetari i komunës, kryesuesja e kuvendit dhe anëtarët e kuvendit të cekur si në pikën 1 të këtij vendimi.

5. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**  
  
**Kryesuese e Kuvendit**

